



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:070531

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05468311

P.nr.2023:070532

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.V., me vendbanim në Ferizaj në Rrugën “ ... ” i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.239/23 të datës 17.03.2023, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, prokurorit të shtetit Alber Zejnullahu, të akuzuarit L.V., me mbrojtësin e tij me autorizim Av. Burim Krasniqi, me datë 27.02.2024 morri dhe publikisht shpalli kurse me datën 19.03.2024, e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari, **L.V.**, me vendbanim në Ferizaj në Rrugën “ ... ”, i lindur më ..., në Ferizaj, nga i ati M. dhe e ëma S. e gjinisë K., me vendbanim në rrugën “ ... ” gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

- me e datën 27.11.2022, në Ferizaj me dashje dhe me qëllim të frikësimit ose shkakimit të ankthit e ka kanosur seriozisht se do ta privoj nga jeta të dëmtuarën R.D., në atë mënyrë që i njëjti kishte marr disa fotografi të saj dhe e kishte hapur një adresë në rrjetet sociale në emrin e të dëmtuarës dhe pastaj e kishte e kanosur me fjalët se “ kam me të marr e me të ngreh zhag dhe ka me të vra”, me ç’ rast të dëmtuarës i kishte shkaktuar shqetësim , frik dhe pa siguri,-

-me të cilën ka kryer veprën penale “ Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39 par1 nënpar 1.1, 40 par.1. nën par 1.3, 43, 69, 70, 71, të KPK-së dhe nenit 358, 359, 360, 361, 364, 365, 449, 462, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), e

G J Y K O N

Të akuzuarit **L.V.**, i shqipton : dënim me gjobë në shumën prej 200 €uro (dyqind euro) të cilën duhet ta paguaj në dy këste mujore në afat prej tre muajsh, konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke e zëvendësuar dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) euro gjobë, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së,.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €uro (tredhjet euro), si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara **R.D.** me adresë në rrugën “... “në Ferizaj, për realizimin e kërkesën pasurore-juridik është udhëzuar në procedure civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.239/23 të datës 17.03.2023 kundër të akuzuarit **L.V.**, me vendbanim në Ferizaj në Rrugën “ ”, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata me datën 27.02.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit **Albert Zejnullahu**, i akuzuari **L.V.** dhe mbrojtësin e tij me autorizim **Av. Burim Krasniqi**, pala e dëmtuar është ftuar e ftesë të rregullt por i akuzuari njofton gjykatën se e njëjta nuk gjendet në Kosovë, gjendet jashtë vendit.

Bazuar në Nenin 240 paragrafi 2 i KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), thuhet: *”Pala e dëmtuar ose viktimia dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës*

njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, por mungesa e tyre nuk është pengës për mbajtjen e seancës”.

Gjykata konform nenit 241 paragrafi të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), të akuzuarin L.V., e ka udhëzuar për të drejtat e tij, ku i akuzuari dekoron i kam kuptuar në tërësi udhëzimet nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu, i lexon aktakuzën të akuzuarit, dhe pas leximit, gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij i ka dhënë mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë.

I akuzuari L.V., deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për veprën penale që e ka kryer, tani me të dëmtuarën nuk kam kontakt më, ajo gjendet jashtë vendit, nuk kemi pas probleme pas rast, tani kam krijuar familjen time kam gruan fëmijët, pretoj se në të ardhmen nuk do të kryer vepra të tilla apo të ngjashme i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr të gjitha rrethanat lehtësuese pasi që është hera e pare që ndeshet me ligjin.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjyqtari në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit mbrojtjes së viktimave. Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit L.V., Av.Burim Krsniqi, deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë, pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim, i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë në pajtim me dispozitat e KPRK-së, kërkojë nga Gjykata që të pranoj pranimin e fajësisë, dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit: Raporti i Oficerit i datës 27.11.2022, Deklarata e dëmtuarës të dhënë në polici me datë 25.01.2023 si dhe me datë 15.03.2023, Deklarata e të pandehurit të dhënë në polici me datë 25.01.2023,si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se: i akuzuari L.V., me e datën 27.11.2022, në Ferizaj me dashje dhe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit e ka kanosur seriozisht se do ta privoj nga jeta të dëmtuarën R.D., në atë mënyrë që i njëjti kishte marr disa fotografi të saj dhe e kishte hapur një adresë në rrjetet sociale në emrin e të dëmtuarës dhe pastaj e kishte e kanosur me fjalët se “ kam me të marr e me të ngreh zharg dhe ka me të vra”, me ç’ rast të dëmtuarës i kishte shkaktuar shqetësim , frik dhe pa siguri,-

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 181 paragrafi 2 të KPRK-së thuhet: ” Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit “.

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjyqtari i çështjes të akuzuarin L.V., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, e bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, është penduar thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsëritë këtë vepër penale. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes, tani është i martuar ka krijuar familje, e dëmtuar nuk gjendet në Kosovë, ndërsa rrethana rënduese jashtë elementeve të veprës penale gjykata nuk konstatoi në këtë rast. Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është sjellë në bazë të nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPP-së, dhe neni 6, par. 1.5 dhe neni 39, par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.2023:070532 me datë 19.03.2024

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.